

Plani i implementimit

Për parimet në vazhdim është arritur pajtueshmëri nga të dyja palët për organizimin e punës së Këshillit të Implementimit

- Hapat e implementimit në të gjitha fushat e renditura më poshtë duhet të ndërmerren njëkohësisht
- Ky plan do t'i nënshtrohet përditësimit sipas nevojës nga të dyja palët në Këshillin e Implementimit
- Të dyja palët do të vazhdojnë të bëjnë çdo përpjekje që të informojnë zgjedhësit e tyre respektivë për përmbajtjen e “Marrëveshjes së Parë” dhe Planit të Implementimit

Implementimi do të ketë gjashtë elemente kryesore:

- Përshtatja e kornizave ligjore
- Asociacioni/Bashkësia
- Policia
- Drejtësia
- Zgjedhjet lokale
- Dispozitat e përgjithshme

1. Përshtatja e kornizave ligjore

Fundi i majit:

Të dyja palët do të paraqesin për diskutim para Këshillit të Implementimit planet e tyre të detajuara dhe afatet kohore për ndryshimet e nevojshme ligjore për implementimin e “Marrëveshjes së Parë”.

Deri në mes të qershorit:

Të dyja palët do t'i kenë miratuar të gjitha ndryshimet e nevojshme ligjore të cilat kërkohen për implementimin e “Marrëveshjes së Parë”, duke përfshirë Ligjin për Amnisti.

2. Asociacioni/Bashkësia

Deri në fund të majit

Të dyja palët do të krijojnë një Ekip Menaxhues për themelimin e Asociacionit/ Bashkësisë, me kushtet e referimit të cilat i cakton Këshilli i Implementimit. Këto kushte referimi do të përfshijnë edhe nxjerrjen e një projekt statuti. Ekipi do të ngarkohet me të gjitha çështjet relevante për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë dhe do të ketë përkohësisht kompetencat e parapara në Pikën 4 dhe 6 të “Marrëveshjes së Parë”. Ekipi Menaxhues do të përbëhet nga përfaqësuesit e katër komunave veriore dhe do të themelohet pas miratimit nga autoritetet kompetente të Kosovës. Këshilli i Implementimit do të mbikqyrë punën e Ekipit Menaxhues.

Deri në fund të tetorit

Pas zgjedhjeve lokale dhe pas certifikimit të rezultateve të tyre, Ekipi Përgatitor do të shpërbëhet. Asociacioni/Bashkësia sipas pikës 1 të “Marrëveshjes së Parë” do të themelohet dhe do të miratojë Statutin e vet në përputhje me Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale dhe me ligjet e Kosovës.

3. Policia

Fundi i majit

Të dyja palët do të formojnë një grup punues për implementimin e pikave 7-9 të “Marrëveshjes së Parë”. Me ndihmen e EULEX-it, grupi punues do të zhvillojë plane të detajuara dhe afate kohore për integrimin e personelit serb të sigurimit në strukturat e Kosovës dhe themelimin e çfarëdo strukture të re që del nga marrëveshja.

Një ushtrues detyre i Komandantit Rajonal të Policisë do të emërohet për katër komunat veriore në pajtim me pikën 9 të “Marrëveshjes së Parë”.

Deri në mes të qershorit

Serbia do të fillojë t’i mbyllë lokalet e strukturave të veta të sigurisë në Kosovë.

Serbia do të ofroj informacione të detajuara për numrin dhe gradat e të punësuarve nga qeveria serbe në sektorin e sigurisë në Kosovë të cilët kanë shprehur interesimin t’u bashkohen strukturave të Kosovës.

Kosova do të ofrojë pozita në Policinë e Kosovës dhe strukturat tjera ekuivalente të Kosovës duke u bazuar, me aq sa ka mundësi, në vendin ku ata jetojnë.

Serbia do të fillojë procedurat e nevojshme të brendshme për ndërprerjen e pagave për personelin pas inkorporimit të tyre në strukturat e Kosovës, dhe do t’i paraqesë këto para grupit punues. Ky proces do të fillojë me rastin e personelit që veç është duke shërbyer në Policinë e Kosovës.

Deri në mes të korrikut

Të gjitha lokalet e strukturave të sigurisë së Serbisë në Kosovë do të mbyllen.

Deri në fund të vitit

Anëtarët e strukturave serbe të sigurisë në Kosovë do të jenë plotësisht të integruar në strukturat ekuivalente të Kosovës dhe pagat do t’u paguhet ekskluzivisht nga buxheti i Kosovës.

4. Drejtësia

Deri në fund të majit:

Të dyja palët do të themelojnë një grup punues për implementimin e pikës 10 të “Marrëveshjes së Parë”. Grupi punues do të përpilojë plane të detajuara për integrimin e autoriteteve gjyqësore serbe në strukturat e Kosovës dhe themelimin e çfarëdo strukture të re të kërkuar me këtë marrëveshje, duke përfshirë gjykatat themelore dhe zyrat e prokurorit publik në komunat me shumicë serbe, e që do të realizohen në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës dhe me ndihmën e EULEX-it.

Do të ketë një marrëveshje për një datë dhe plan për një suspendim të rasteve të reja që po dëgohen në sistemin e gjykatave serbe në Kosovë.

Deri në mes të qershorit

Serbia do të ofroj informacione për numrin e personelit të saj gjyqësor të punësuar në Kosovë të cilët kanë shprehur interesim t'u bashkohen strukturave të Kosovës, menjëherë pasi të miratohet ligji për amnestinë.

Kosova do të ofrojë pozita në strukturat e saja gjyqësore.

Përbërja e këtij gjyqësori duhet të reflektojë përbërjen etnike të jurisdiksionit territorial për secilën gjykatë respektive.

Deri në fund të vitit:

Integrimi i autoriteteve gjyqësore do të ketë përfunduar. Të gjitha lokalet e gjykatave serbe në Kosovë do të jenë mbyllur, përderisa do të ngritën struktura të reja dhe personeli do të integrohet në sistemin kosovar. Nuk do të ketë ndërprerje në shërbime.

5. Zgjedhjet lokale

Deri në javën e parë të qershorit:

Këshilli i Implementimit do të nisë diskutime në lidhje me mbajtjen e zgjedhjeve lokale. OSBE-ja do të marrë pjesë në këto diskutime dhe do të udhëheqë çdo grup të nevojshëm punues në lidhje me këtë temë.

Deri në fund të tetorit:

Zgjedhjet lokale do të jenë mbajtur.

6. Dispozitat e përgjithshme

- **Transparenca e financimeve:** Deri nga fundi i majit, Serbia do të ofrojë një pasqyrë të detajuar të të gjitha financimeve të institucioneve në Kosovë përmes Këshillit për Implementim. Nga mesi i korrikut, mënyra për realizimin e parimeve për financim transparent do të përcaktohet nga të dyja palët në Këshillin për Implementim.
- **Implementimi i plotë i të gjitha marrëveshjeve** të arritura më parë në procesin e Dialogut. Të dy palët përkushtohen që të implementojnë në tërësi marrëveshjet e arritura më herët, domethënë:

Kadastrat

Regjistrat civil

Vula doganore

Diplomat universitare

Lirija e lëvizjes

Përfaqësimi rajonal

Menaxhimi i Integruar i Kufijve (IBM)

Marrëveshjet për zyrat ndërlidhëse

Njësia speciale e policisë për mbrojtjen e Trashëgimisë Fetare dhe Kulturore

Mbledhja e taksave doganore/fondi i zhvillimit për Kosovën veriore

Dy palët do të vazhdojnë dialogun politik.